


TaxNews

Shkurt 2019
February 2019



Ndryshimet ligjore të sjella nëpërmjet Paketës Fiskale 2019 (të përmbledhura në serinë e publikimeve tona të njëpasnjëshme në shtator dhe dhjetor 2018) janë reflektuar edhe në Udhëzimet përkatëse të Ministrit të Financave. Në Fletoren Zyrtare nr. 23 është publikuar Udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 22.02.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar", nëpërmjet të cilit reflektohen ndryshimet e shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizime të caktuara të mallrave dhe shërbimeve, si më poshtë:

I. Furnizimi i shërbimit të reklamave

Reflektohet ndryshimi i trajtimit me normë të reduktuar të furnizimeve të reklamave nga mediat audiovizive

Udhëzimi ndryshues paraqet shembuj të cilët sqarojnë se:

- Furnizimi i reklamave nga media audiovizive është i tatueshëm me normë të reduktuar të TVSH-së prej 6%;
- Çdo veprimtari tjetër me natyrë tregtare e kryer nga mediat audiovizive, me përjashtim të reklamës, është furnizim i tatueshëm me normë standarte të TVSH-së prej 20%;
- Furnizimi i reklamave nga persona të tjerë të tatueshëm që nuk janë media audiovizive është i tatueshëm me shkallën standarde të TVSH-së prej 20% (me përjashtim të shërbimit të reklamave nga media e shkruar i cili është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja).

The legal amendments brought through the Fiscal Package 2019 (summarized in our successive series of publications in September and December 2018) are reflected also in the respective Instructions of the Minister of Finance.

In the Official Gazette no. 23 is published the Instruction of the Minister of Finance and Economy no. 5, dated 22.02.2019 'On some additions and amendments to the instruction no. 6, dated 30.01.2015 "On value added tax in the Republic of Albania", as amended' through which are reflected the amendments of the reduced rate of value added tax for certain supplies of goods and services as follows:

I. Supply of advertising services

It is reflected the change of treatment with a reduced rate of advertising supplies provided from audiovisual media

The amending instruction presents examples that clarify that:

- The supply of advertising services from audiovisual media is taxable at a reduced rate of VAT of 6%;
- Any other commercial activity performed by audiovisual media, with the exception of advertising, is a taxable supply at the standard rate of VAT of 20%;
- The supply of advertising services by other taxable persons other than audiovisual media is taxable with the standard VAT rate of 20% (with the exception of advertising services by written media which is a supply exempt from VAT).

II. Përjashtimi i gazetave, revistave dhe reklamës nga media e shkruar

Sa më poshtë nuk janë më furnizime të përjashtuara nga TVSH:

- **Furnizimi i librave të ofruara në mënyrën tradicionale** (nga 1 janar 2019 është subjekt i normës së reduktuar të TVSH-së prej 6%).
Personi i tatueshëm që furnizon libra në formën tradicionale subjekt i normës së reduktuar të TVSH-së prej 6%, zbrit normalisht TVSH-në për të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve të realizuara në funksion të veprimtarisë së tij të tatueshme.

Në rastet kur materialet ofrohen jo në formën tradicionale të një libri, pavarësisht përmbajtjes apo leximit nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse, përfshirë ato elektronike nuk është furnizim me shkallë të reduktuar të TVSH-së prej 6%, por do të zbatohet norma standarte e TVSH-së prej 20%.

- **Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media elektronike** (nga 1 janari 2019 është furnizim i tatueshëm subjekt i normës standarde të TVSH-së prej 20%).

III. Furnizimi i përpunimit të mallrave nën regjimin e përpunimit aktiv

Reflektohet në udhëzim trajtimi si eksport me 0% TVSH, furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave nga nënkontraktorë për operatorë ekonomikë që veprojnë në sektorin e përpunimit aktiv.

II. Exemption of newspaper, magazines and advertising from written media

The following are no longer VAT exempted supplies:

- **Supply of books provided in the traditional way** (from 1 January 2019 is subject of the reduced VAT rate of 6%).
The taxable person that supplies books in their traditional way subject of the reduced VAT rate of 6%, normally deducts the input VAT for all the purchases of goods and services received for the purposes of its taxable activity.

In the cases where the materials are not offered in the traditional way of a book, notwithstanding the content or reading through other assisting equipment, including electronic equipment is not a supply subjected to the reduced VAT rate of 6%, but instead the standard VAT rate of 20% will be applicable.

- **Supply of advertising services from electronic media** (from 1 January 2019 is a taxable supply subject of the standard VAT rate of 20%).

III. Supply of processing of goods under active processing regime

It is reflected in the instruction the treatment as export at 0% VAT, the supply of services for processing of goods by subcontractors for economic operators that operate in the active processing sector.

Gjithashtu furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave nga nënkontraktorët e pajisur me autorizimin përkatës nga autoriteti doganor, për llogari të shoqërive të përpunimit aktiv do të trajtohet si furnizim shërbimi i tatueshëm me TVSH 0%.

Për zbatimin e këtij trajtimi, çdo person i tatueshëm nënkontraktor, menjëherë me marrjen e autorizimit nga ana e autoritetit doganor paraqet kërkesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse me një kopje të autorizimit të lëshuar nga autoriteti doganor, i cili e njeh kontraktorin si të tillë, së bashku me një kopje të kontratës së lidhur midis palëve. Drejtoria Rajonale Tatimore duhet të lëshojë autorizimin "Për përfshirjen në operacione të përpunimit aktiv" për nënkontraktorin brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit nga ana e autoritetit doganor.

Furnizimet e shërbimit në kuadër të regjimit të përpunimit aktiv nuk mund të kryhen nga nënkontraktorë të paautorizuar nga autoritetet doganore dhe tatimore përkatëse.

IV. Përcaktimi i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike gjatë procesit të shpërndarjes

Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike, "humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike" nuk do të konsiderohet më përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje e miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE), por përqindja e humbjeve siç përcaktohet në VKM nr. 434, datë 20.5.2015 "Për përcaktimin e normativave për firot, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale".

Furthermore, the supply of services for processing goods from subcontractors equipped with the respective authorizations from the customs authority, on behalf of the companies of active processing will be considered as a supply of service taxable with a VAT rate of 0%.

For the implementation of this treatment, each taxable person subcontractor, upon receipt of the authorization by the customs authority, shall submit a request to the relevant Regional Tax Directorate with a copy of the authorization issued by the customs authority, which recognizes the contractor as such, along with a copy of the contract concluded between the parties. The Regional Tax Directorate should issue the "For inclusion in active processing operations" authorization for the subcontractor within 30 days from the date of issuance of the authorization by the customs authority.

Service supplies within the active processing regime can not be carried out by unauthorized subcontractors from the relevant customs and tax authorities.

IV. Determination of network electricity losses during the distribution process

In the case of electricity supply, "loss of electricity distribution" shall not be considered the percentage of electricity losses distributed by the Energy Regulatory Entity (ERE), but the percentage of losses as defined in the DCM no. 434, dated 20.05.2015 "On determining normatives for losses, damage and scratch during production, storage, transportation, etc., recognized for fiscal purposes".

Deloitte Contacts

Olindo Shehu, CPA

Partner | Tax & Legal Services

Deloitte Albania sh.p.k

Rr. "Elbasanit", Pallati prane Fakultetit

Gjeologji Miniera

Tirana | Albania

Mob: +355 68 60 33 116

E-mail: oshehu@deloitteCE.com

Disclaimer:

This publication contains general information only, and none of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, any of its member firms or any of the foregoing's affiliates (collectively the "Deloitte Network") are, by means of this publication, rendering accounting, business, financial, investment, legal, tax, or other professional advice or services.

This publication is not a substitute for such professional advice or services, nor should it be used as a basis for any decision or action that may affect your finances or your business. Before making any decision or taking any action that may affect your finances or your business, you should consult a qualified professional adviser. No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

No entity in the Deloitte Network shall be responsible for any loss whatsoever sustained by any person who relies on this publication.

Deloitte refers to one or more of Deloitte Touché Tohmatsu Limited, a UK private company limited by guarantee, and its network of member firms, each of which is a legally separate and independent entity. Please see www.deloitte.com/al/about for a detailed description of the legal structure of Deloitte Touché Tohmatsu Limited and its member firms.

Deloitte provides audit, tax, consulting, and financial advisory services to public and private clients spanning multiple industries. With a globally connected network of member firms in more than 150 countries, Deloitte brings world-class capabilities and deep local expertise to help clients succeed wherever they operate. Deloitte's approximately 290,000 professionals are committed to becoming the standard of excellence.